



07-11-2023
07-11/01-1337
Republika e Kosovës

Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Vitisë/Opština Vitina/Municipality of Viti



Në bazë të Rregullorës për Ndarjen e Bursave për Studentë të Komunës së Vitisë Nr. 01-013/246, neni 3, 6, 8, 9 dhe neni 10, si dhe buxhetit të planifikuar dhe të paraparë për këtë destinim, Komuna e Vitisë shpallë:

KONKURS PUBLIK

për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Vitisë për vitin akademik 2023/24

Komuna e Vitisë shpallë konkurs publik për ndarjen e 150 bursave (vlera e një burse 300 €) për vitin akademik 2023/24. Bursat ndahen për studentë të rregulltë, për studentë të drejtimeve deficitare (Matematikë, Fizikë, Gjuhë Gjermane), për studentë të familjeve përfituese të ndihmës sociale, studentë të familjeve të dëshmorëve të luftës, invalid të luftës dhe veteranë të luftës, si dhe studentë të familjeve pa prindër në jetë.

Kriteret për aplikim:

- Të jenë studentë me adresë banimi në Komunën e Vitisë;
- Të jenë studentë të rregullt në Universitetin Publik të Republikës së Kosovës.

Përparësi do të kenë:

- Drejtimet deficitare: Matematikë, Fizikë, Gjuhë Gjermane;
- Studentë me notë mesatare më të lartë;
- Studentë të prindërve të kategorive të dala nga lufta;
- Studentë përfitues të ndihmës sociale;
- Studentë të familjeve pa prindër në jetë;
- Dy ose më shumë studentë të së njëjtës familje (përfitues do të jetë vetëm njëri nga studentët).

Vërejtje: Nuk do të jenë përfitues të bursës komunale studentët përfitues të bursës universitare, studentë të universiteteve private, studentë të nivelit postdiplomik (master, PHD).

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Dokumenti i identifikimit (letërnjoftimi kopje);
- Certifikatë e vendbanimit;
- Certifikata e notave;
- Për studentë fillestar, diploma e shkollës së mesme;
- Vërtetimi i regjistrimit të semestrit për vitin akademik 2023/24;
- ID-në e fakultetit;
- Dëshmi mbi gjendjen ekonomike (rastet sociale);
- Dëshmi se prindërit janë kategori të dala nga lufta;
- Studentë që janë pa prindër të sjellin certifikatën e vdekjes.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Arkivin e Komunës së Vitisë, objekti tek Komuna e re.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, ndërsa dokumentet e pakompletuara nuk merren në shqyrtim.

Viti, më 07.11.2023

Kryetari i Komunës së Vitisë

Sokol Haliti

